

Znj. Elona Llozana ka përfunduar studimet e larta në vitin 2007 në Universitetin Ismail Qemali, Vlorë, në degën Menaxhim Biznesi.

Ajo ka një eksperiencë prej rreth 12 vite në sektorin Tatimor, (2006-2017) në pozicione të ndryshme të drejtorive si inspektore e parë por edhe si drejtuese prej vitit 2011 e në vazhdim, ndërsa në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka 7 vite eksperiencë. Që nga viti 2017 ka ushtruar detyrën e auditueses në departamentet e auditimit dhe nga viti 2018-2023 ka qenë në pozicionin e Auditueses së Lartë.

Aktualisht Znj. Llozana ushtron detyrën e Kryeauditueses në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore, në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Gjatë karrierës së saj ka ndjekur disa trajnime të rëndësishme kombëtare për rritjen e kapacitetit profesional si për legjislacionin tatimor ashtu edhe në fushën e auditimit dhe Standardet e Intossait.

Gjithashtu, në vijimësi ka marrë pjesë në trajnime, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në tema që lidhen me auditimin e jashtëm.

Znj. Llozana është njohëse shumë e mirë e gjuhës angleze dhe gjuhës italiane.